

**DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME
TË KOSOVËS PËR
ÇËSHTJE QË LIDHEN
ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT**

**SPECIAL CHAMBER OF
THE SUPREME COURT
OF KOSOVO ON KOSOVO
TRUST AGENCY
RELATED MATTERS**

**POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU
AGENCIJU**

ASC-10-0031

Në padinë e

[REDACTED]

Paditësi/Ankuesi

[REDACTED] Prishtinë

kundër

[REDACTED]

Të Paditurit

Llapje Sellë

[REDACTED]

NSH, Kombinati Bujqësor Industrial,
Fushë Kosovë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS) i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësit kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 4 shkurt 2010, SCC-09-0037, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 gusht 2010, lëshon këtë:

AKTVENDIM

1. Ankesa është e bazuar.

2. Hedhet poshtë aktvendimi i DHPGJS-së të datës 4 shkurt 2010, SCC-09-0037 dhe urdhërohet Trupi Gjykses ta rigjykojë padinë.

3. Trupi Gjykses do të duhet të vendos për shumën e shpenzimeve në procedurën e shkallës së parë dhe ndarjen e tyre ndërmjet palëve, si dhe ndarjen e shpenzimeve të procedurës ankimore

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Më 13 mars 2009, paditësi ushtroi padi pranë DHPGJS me të cilën kërkonte që Paditësit ti kthehet 0,90 ha tokë të regjistruar në emër të të Paditurve pasi e ka ushtruar një padi identike pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës, e cila e ka shpallur veten jo kompetente. Paditësi pretendonte se toka, e përbërë prej ngastrës së tokës së lëvrueshme tek Livacki Put me sipërfaqe prej 0,30 ha dhe ngastrës së tokës së lëvrueshme në Suljina-njiva afër fshatit Çagllavicë me sipërfaqe prej 0,60 ha, ishte konfiskuar më 18 gusht 1954 nga ai për shkak të Reformës së Tokave dhe Kolonializmit të Brendshëm të Republikës Popullore të Serbisë dhe ishte regjistruar në Fondin e Tokës Bujqësore. Ai ka kërkuar që toka ti kthehet atij.

Më 31 mars 2009, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër dhe kërkoi nga Paditësi që të dorëzojë, mes tjerash, konfirmimin se njoftimi në pajtim me nenin 28.2 (e) të UA të UNMIK-ut 2008/6 i është dërguar me kohë Agjencisë.

Më 21 Prill 2009, paditësi dorëzoi një kopje të njoftimit me shkrim të dërguar Agjencisë për iniciimin e procedurës gjyqësore para Dhomës së Posaçme të datës 14 prill 2009. Më 11 qershor 2009, Paditësi dorëzoi kopjet e dy njoftimeve me shkrim për Agjencinë për iniciimin e procedurës gjyqësore në këtë lëndë, të datave 3 qershor 2009 dhe 10 qershor 2009.

Më 4 shkurt 2010, Trupi Gjykses i DHPGJS-së e refuzoi padinë si të papranueshme. Trupi Gjykses vlerëson se paditësi nuk i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të parapara me nenin 28.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6, pasi që nuk ka ofruar dëshmi se njoftimi është pranuar nga Agjencia. Për më shumë, Trupi Gjykses ka vlerësuar se tri njoftime të ndryshme që i janë bërë Agjencisë

III

nuk janë të kënaqshme, për shkak se ato janë dorëzuar vetëm pasi që është ushtruar padia dhe kështu Agjencia nuk ka pasur "mundësinë të veprojë siç ka dëshiruar".

Aktvendimi i Trupit Gjykses i është dorëzuar Paditësit (tash e tutje Ankuesi) më 12 shkurt 2010 dhe Ankuesi e ka ushtruar një ankesë më 8 mars 2010.

Në ankesën e tij, Ankuesi kërkon nga Kolegji i Ankesave ta modifikojë aktvendimin e Trupit Gjykses dhe ta aprovojë padinë origjinale ose, si alternativë, ta hedh poshtë aktvendimin dhe t'ia përcjellë lëndën shkallës së parë për rigjykim. Ankuesi vlerëson se Trupi Gjykses i ka zbatuar gabimisht dispozitat relevante ligjore të cilat kanë çuar në shkelje thelbësore të ligjit procedural dhe atij material.

Ankuesi vlerëson se ai e ka njoftuar me kohë AKM-në për procedurat e mëparshme para Gjykatës Komunale të Prishtinës, por në anën tjetër ai gjithashtu ka përmendur se njoftimi ka mundur të mos jetë regjistruar apo edhe të ketë humbur në AKM. Ankuesi e konteston faktin se Trupi Gjykses e ka përmbushur obligimin për të dhënë një arsyetim të duhur.

Arsyet ligjore:

Ankesa është e pranueshme dhe e bazuar.

Njoftimi Agjencisë:

Neni 29.1 i RREG së UNMIK-ut 2002/12 duhet të interpretohet jo vetëm sipas mënyrës së formulimit të fjalëve por gjithashtu duke marrë parasysh ratio legës të dispozitës.

Në bazë të nenit 29.1 të RREG të UNMIK-ut 2002/12, njoftimi me shkrim i qëllimit për të ushtruar padi kundër një NSH-je duhet t'i bëhet Agjencisë para dorëzimit të padisë. Njoftimi i Agjencisë për qëllimin për të ushtruar padi është ndër kriteret e pranueshmërisë siç parashihet me nenin 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Edhe pse kriteret e pranueshmërisë duhet të shqyrtohen ex officio, në

atë fazë të hershme të procedurës (ende pa u përfshirë e Paditura) vet pohimi i Paditësit se është bërë njoftimi i duhur – në parim - është i mjaftueshëm. Nëse Paditësi pohon (në padi apo në bazë të urdhrit në pajtim me 28.4 të UA-së 2008/6) se është parashtruar njoftimi i duhur, Trupi Gjykses nuk mund të hedhë poshtë padinë si të papranueshme, duke u bazuar në mungesën e dëshmisë së atij njoftimi. Përderisa padita të mos jetë e papranueshme mbi bazat tjera, duhet t'i jepet mundësia të Paditurës të merr qëndrim për njoftimin (e pretenduar), së bashku me meritat e lëndës (duke ia dërguar padinë dhe dokumentet tjera të Paditurës; *audiatur et altera pars*). Atëherë, i mbetet të Paditurës të kontestojë faktet që gjenden në padi, përfshirë njoftimin (e afatshëm) të pretenduar. Vetëm nëse e Paditura (në mënyrë potenciale e përfaqësuar nga Agjencia) e konteston (afatshmerinë e) njoftimit, do t'i kërkohet Paditësit të vërtetojë njoftimin.

Në rastin konkret, e Paditura ende nuk ka pasur rast ta kontestojë njoftimin. Sipas Paditësit/Ankuesit, ai ia ka dorëzuar agjencisë tri njoftime të ndryshme (të datave 14 prill, 3 qershor dhe 10 qershor 2009). Pa marrë parasysh njoftimin e parë të paafatshëm (padija është pranuar nga DHPGJS më 13 mars 2009), mund të shihet se, nga 22 janari 2009, AKP-ja ka qenë në dijeni për padinë e ardhshme që do ti parashtrohej DHPGJS për shkak të procedurës së mëparshme gjyqësore në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Që nga atëherë, ajo nuk ka zgjedhur ta zgjidh kontestin me Ankuesin. Duke pasur parash se qëllimi i njoftimit "nuk është që ti japë Agjencisë mundësi për të vepruar siç ka dëshiruar" por për ta informuar Agjencinë për paditë (e mundshme) dhe tu jep atyre mundësi që ta marrin çështjen në dorë në emër të NSH-së së involvuar (shih prapë nenin 29.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12) *ratio legis* e njoftimit në ndërkohë është plotësuar (vendimi i atakuar është marrë më 4 shkurt 2010). Përveç kësaj, duhet marrë parasysh se detyra e paditësit që ta njoftoi Agjencinë më herët shton edhe një barrë tjetër për të sa i përket qasjes në drejtësi; andaj dispozita duhet të interpretohet në mënyrë restriktive. Në këtë gjendje- dhe për aq sa njoftimi nuk kontestohet – Kolegji i Ankimeve e konsideron çështjen e njoftimit të mos ketë rëndësi (të mëtutjeshme) sa i përket gjykimit të padisë (ASC-09-0072, ASC-09-0057, ASC -10-0027, ASC-10-0036, et al).

Kështu, hedhja poshtë e padisë si e papranueshme nuk ka qenë me vend. Andaj vendimi i atakuar nuk mund të qëndrojë dhe duhet të hedhet poshtë. Trupi Gjyqësor duhet (përsëri) të merret me padinë, duke u përmbajtur nga ndonjë tjetër anulim i tij duke u bazuar në bazat e përshkruara më lart.

Udhëzimet për parashtrimin e ankesës:

Sa i përket ankesës, Kolegji i Ankesave dëshiron të theksojë se udhëzimet për parashtrimin e ankesës duke e cituar ligjin pa ndonjë zgjidhje nga ana e gjykatës, nuk janë aktvendime dhe si të tilla nuk mund – siç është dhënë në pikën 2 të aktvendimit të kontestuar – të përfshihen në dispozitiv. Informata e tillë mund të jepet në kuadër të arsyetimit ligjor ose – më mirë – vetëm ti bashkëngjitet aktvendimit, por nuk mund të jetë pjesë e tij (shih ASC-09-0108, ASC-10-0036, et al).

Shpenzimet:

Sipas Nenit 11 të RREG 2008/4 dhe Nenit 66 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Trupi Gjyqësor duhet të vendosë mbi caktimin e shpenzimeve të procedurës në shkallën e parë, dhe të Kolegjit të Ankimeve – kur lënda të vendoset përfundimisht- mbi caktimin e shpenzimeve procedurale në të dyja shkallët. Lënda në fjale duhet rigjykuar në shkallën e parë; andaj, tash për tash nuk mund të ketë vendim mbi caktimin e shpenzimeve, meqë ky caktim varet nga vendimi pasues i Trupit Gjyqësor.

Më 6 tetor 2009, kërkesa e Paditësit/Ankuesit për ndihmë në përkthim është aprovuar dhe Ankuesi është liruar nga taksat gjyqësore. Në pajtim me Rregullat Plotësuese Procedurale të aplikueshme mbi Taksat Gjyqësore të DHPGJS që janë në fuqi që nga 21 qershori 2010, që ndryshojnë Rregullat Plotësuese Procedurale mbi Taksat Gjyqësore të datës 10 mars 2010, taksat gjyqësore të procedurës ankimore që duhet të barten nga Ankuesi duhej të ishin 60 euro dhe shpenzimet për përkthim që dalin nga procedura ankimore 30 euro.

Sipas nenit 22 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore (tash e tutje LTGJ, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 3 tetor 1987) nëse në një procedurë civile mbi një padí private, pala që është liruar nga taksat gjyqësore fiton,

VI

shpenzimet që pala do të ishte e detyruar ti paguajë po të mos ishte liruar nga ajo pagesë do të paguhen nga pala e cila nuk e gëzon lirim, pikërisht në përpjesëtim në të cilin pala e liruar ka pasur sukses në procedurë.

Shpenzimet e përkthimit të kryera nga DHPGJS janë të krahasueshme me taksat gjyqësore dhe prandaj duhet të bëhen në të njëjtën mënyrë.

Në pajtim me nenin 22 të LTGJ, në rastin konkret, kur të bëhet caktimi i shpenzimeve, d.m.th. taksat gjyqësore dhe për përkthim nga të cilat Ankuesi është liruar, do të paguhen nga pala kundërshtare e Ankuesit varësisht nga sukcesi i arritur në procedurë nga Ankuesi. Këto shpenzime në procedurën ankimore arrijnë shumën prej gjithsej 90 euro.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues

EULEX

Torsten Koschinka, Gjyqtar

EULEX

Eija -Liisa Helin, Gjyqtare

EULEX

Tobias Lapke, Regjistrues

EULEX
